

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SOLAR ENERGY CELLS” SH.P.K.**

Sot, me date 16/02/2022 (dymije e njezet e dy), i pranishem:

- **Z. Aleks HASA**, shtetas shqiptar, lindur më 10.06.1979 në Kukës e banues ne Tirane, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. personal H90610109B.
- **Znj. Vojushe DALIPAJ**, shtetase shqiptare, lindur më 21.02.1973 në Vlore e banuese po aty, mbajtëse e Letërnjoftimit ID me Nr. personal H35221093L.
- **Z. Florjan ALMADHI**, shtetas shqiptar, lindur më 15.02.1989 ne Tirane e banues po aty, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. personal I90215063D.

te cilet ne cilësinë e ortakeve themelues shpallen hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akt Themelimi në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me termat si me poshtë vijon:

**NENI 1
EMËRTIMI**

Themelohet një shoqeri e se drejtës shqiptare me perjegjesi te kufizuar me emertimin **“SOLAR ENERGY CELLS” sh.p.k.**

**NENI 2
SELIA**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Blv. Ismail Qemali, Pallati Kali i Trojes, Kati 1 9401, Qyteti Vlore, Qarku Vlore, Shqipëri. Asamblea Ortakëve mund të vendosë krijimin ose mbylljen e selive dytësore, filialeve, zyrave të përfaqësimit dhe degëve të shoqërisë ose transferimin e selisë së shoqërisë në qytete të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Vendbanimi i ortakeve për të gjitha marrëdhieniet me shoqerinë është ai që rezulton nga akti i themelimit ose nga njoftimet e mëvonshme të tyre dërguar pranë selisë së shoqërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin e Shoqërive Tregetare deri sa të mbyllet me akte ligjore.

**NENI 4
OBJEKTI**



1

Objekti i Shoqërisë është:

Ndertimi, Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaikë, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmëse. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marjen e të gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, institucionet përgjegjëse Shtetërore (qofshin këto organe Qëndrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vëndas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 ALL (njeqind mijë) dhe është i përbërë nga 3 (tre) kuota.

Kapitali themeltar zotërohet si më poshtë:

- **Aleks HASA** zotëron 1 (një) kuote që perfaqëson 90 % (nenedhjete) të kapitalit, me vlerë 90,000 ALL (nenedhjete mijë)
- **Vojushe DALIPAJ** zotëron 1 (një) kuote që perfaqëson 6 % (gjashte) të kapitalit, me vlerë 6,000 ALL (gjashte mijë)
- **Florjan ALMADHI** zotëron 1 (një) kuote që perfaqëson 4 % (kater) të kapitalit, me vlerë 4,000 ALL (kater mijë)

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe organi administrativ. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë dhe vepron në përputhje me statutin e shoqërisë dhe ligjet në fuqi.

Organi i vetëm Administrativ i shoqërisë është Administratori i saj i vetëm,

- **Z. Florjan ALMADHI**, shtetas shqiptar, lindur më 15.02.1989 ne Tirane e banues po aty, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. personal I90215063D, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar; që do të qëndrojë në detyrë për një periudhë prej 5 vitesh me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa parashikohet nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga statuti i shoqërisë. Administratori ka të drejta dhe kompetenca të plota për kryerjen e të gjitha veprimeve që do



2

të konsiderojë të dobishme për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që kërkojnë miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.
Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhene me të tretët, përpara organeve shtetërore dhe private.

NENI 7
PJESËMARRJA NË SHOQËRI TË TJERA

Ortaket mund të vendosin lirisht pjesëmarrjen në shoqëri të tjera si dhe të fillojnë çdo lloj aktiviteti tjetër tregtar në territorin e Shqipërisë, me kushtin që të mos jetë konkurues me ate të shoqërisë së themeluar prej tyre.
Cdo veprimtari qe bie ndesh me paragafin e sipërpermendur nuk do te konsiderohet si konflikt interesit nese mer votbesimin e të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) te ortakeve.

NENI 8
LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ne te ardhmen ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhieniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje si fillim me marrveshje mes palëve ose në të kundërt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10
DISPOZITA FINALE

Ky akt themelimi u hartua në katër njësi të barazvlefshme e njejtë në gjuhën shqipe, nga ortaku i shoqërisë, i cili njëkohësisht autorizon Florjan Almadhin për depozitimin e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit.

ORTAKET THEMELUES

ALEKS HASA



anja li përdorur që së paktën është e rastësishme që mëdha e përcakta e
përcakta të cilat nuk ka mundur që të bëjë qëndrimin që dëshironi që
të bëjë.

VOJUSHE DALIPAJ

Vojushe Dalipaj

qëllimi i këtij përkrahje është që t'i përcaktojë që mëdha e përcakta
shtetit që dëshironi që t'i bëjë.

FLORJAN ALMADHI

qëllimi i këtij përkrahje është që t'i përcaktojë që mëdha e përcakta
shtetit që dëshironi që t'i bëjë.

Florjan Almadhi

DEPUTAT
MINISTRI I PUBLIKUARA

P

Si ajo mës, përkrahje është që t'i përcaktojë që mëdha e përcakta
shtetit që dëshironi që t'i bëjë.

DEPUTAT
MINISTRI I PUBLIKUARA

veçkësia t'jemi që së paktën zyrtaritët e tregut që
nuk ka mundur që t'i përcaktojë që mëdha e përcakta
shtetit që dëshironi që t'i bëjë.

DEPUTAT

BLAJMIJA TESKOMI

qëllimi i këtij përkrahje është që t'i përcaktojë që mëdha e përcakta
shtetit që dëshironi që t'i bëjë.

ZELLEMËSIT TË KATËRË

AKT DOKTORA